RELACION SHPJEGUES

PËR PROJEKT VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MIRATIMIN E AGJENDËS KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2027-2030

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti propozohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) në cilësinë e institucionit përgjegjës, për hartimin dhe koordinimin e politikave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si një dokument strategjik ndërsektorial i Qeverisë shqiptare.

Qëllimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 2027–2030 (AKDF) është të sigurojë një kuadër strategjik kombëtar, ndërsektorial dhe të orientuar drejt rezultateve, për promovimin, mbrojtjen dhe garantimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në përputhje me Ligjin nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (2023), standardet e Bashkimit Evropian dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Dokumenti strategjik ka natyrë ndërsektoriale dhe synon forcimin e një sistemi të integruar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, duke garantuar akses të barabartë në shërbime cilësore, mbrojtje efektive nga çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, si dhe mundësi të barabarta për zhvillim, mirëqenie dhe pjesëmarrje për çdo fëmijë në Shqipëri.

Vizioni i AKDF është që çdo fëmijë në Shqipëri gëzon të drejta të plota dhe të barabarta, rritet në një mjedis të sigurt, mbrojtës dhe gjithëpërfshirës, ka akses në shërbime cilësore dhe të integruara, mbrohet nga çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi, diskriminimi dhe përjashtimi social, si dhe fuqizohet për të marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën familjare, komunitare dhe shoqërore, duke realizuar potencialin e tij të plotë në një shoqëri demokratike, të drejtë, të qëndrueshme dhe të harmonizuar me standardet evropiane të të drejtave të fëmijëve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE

AKDF 2027-2030 harmonizohet dhe ndërvepron me dokumentet strategjike kombëtare, ndër të cilat janë: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030; Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030; Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022–2029; Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale 2024–2028 në Republikën e Shqipërisë; Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësinë për të Mitur 2022–2026, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve 2022–2026; Strategjia

Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe Plani i Veprimit 2024–2026; Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030; Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030; Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026; Plani i Veprimit i Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030 dhe standardet për arritjen e kompetencave digjitale, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 03.12.2025; Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave dhe procesi për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2026–2030; Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030; Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030; Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri 2026–2030, Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (2024); dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030.

Projektakti është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të akteve të MSHMS, për 4-mujorin e dytë të vitit 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta të njeriut. Fëmijët në Shqipëri dhe në të gjithë botën duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të jenë në gjendje të jetojnë të sigurtë, duke qenë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës.

Në vitin 2025, Shqipëria avancoi ndjeshëm procesin e integrimit europian duke hapur të gjashtë grup-kapitujt e negociatave me Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, çështjet e të drejtave të fëmijëve, përfshirjes sociale, arsimit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor fituan një rëndësi më të madhe në dialogun politik të lidhur me procesin e anëtarësimit në BE.

Sipas UNICEF, Shqipëria renditet e 45-ta nga 167 vende në Indeksin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG Index) për vitin 2025, duke reflektuar progres në qeverisje dhe reforma institucionale, por duke vijuar të përballet me sfida të rëndësishme që lidhen me varfërinë e fëmijëve, pabarazitë dhe aksesin e pabarabartë në shërbime, veçanërisht për fëmijët në zonat rurale, familjet e mëdha dhe komunitetet e margjinalizuara.

Raportet e UNICEF Shqipëri dhe Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë evidentojnë se, megjithëse Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të drejtat e fëmijëve, mbeten sfida të konsiderueshme në garantimin e aksesit të barabartë në shërbime cilësore dhe në reduktimin e pabarazive sociale dhe territoriale.

Nga analiza e UNICEF mbi kapitalin njerëzor rezulton se fëmijët e lindur sot në Shqipëri pritet të arrijnë vetëm 63% të potencialit të tyre produktiv në moshë madhore, nën

mesataren rajonale prej 69%, duke treguar nevojën për investime më të forta në zhvillimin e hershëm, arsim cilësor, mbrojtje sociale dhe mirëqenie të fëmijëve dhe të rinjve.

Raporti i monitorimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 evidenton progres të rëndësishëm në forcimin e kuadrit institucional, ligjor dhe programor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, megjithëse mbeten ende sfida të rëndësishme në drejtim të zbatimit të plotë, koordinimit ndërsektorial dhe garantimit të aksesit të barabartë në shërbime cilësore për çdo fëmijë.

Gjatë periudhës 2021–2025 janë raportuar 170 nga 185 aktivitetet e planifikuara në Agjendë (92%), ku 64% e aktiviteteve rezultojnë plotësisht të realizuara, 27% pjesërisht të realizuara dhe 9% të parealizuara. Nga 20 tregues strategjikë të rezultateve, institucionet kanë raportuar për 17 prej tyre, ku 77% konsiderohen plotësisht të realizuar dhe 18% pjesërisht të realizuar.

Dokumenti synon të forcojë koherencën ndërmjet reformave sektoriale dhe prioriteteve kombëtare për fëmijët, të mbështesë zhvillimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të sigurojë një qasje të koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në adresimin e nevojave të tyre.

Miratimi i këtij dokumenti, synon të konsolidojë dhe forcojë sistemin kombëtar të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve përmes:

- Garantimit të vazhdimësisë dhe përfundimit të reformave të nisura në kuadër të Agjendës 2021–2026;
- Adresimit të boshllëqeve sistemike dhe rreziqeve të reja që prekin fëmijët;
- Forcimit të koordinimit ndërinstitucional, llogaridhënies dhe ofrimit të shërbimeve cilësore në nivel qendror dhe vendor;
- Harmonizimit të politikave kombëtare për të drejtat e fëmijëve me prioritetet, standardet dhe iniciativat e Bashkimit Evropian; dhe
- Forcimit të koherencës me strategjitë sektoriale dhe proceset kombëtare në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë, përfshirjes sociale dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Gjithashtu mundëson reflektimin në mënyrë të strukturuar dhe të matshme, të masave për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve të vitit 2023, si edhe forcimin më tej për përafrimin me standardet evropiane, në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të Ligjit Nr.18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

mesataren rajonale prej 69%, duke treguar nevojën për investime më të forta në zhvillimin e hershëm, arsim cilësor, mbrojtje sociale dhe mirëqenie të fëmijëve dhe të rinjve.

Raporti i monitorimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 evidenton progres të rëndësishëm në forcimin e kuadrit institucional, ligjor dhe programor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, megjithëse mbeten ende sfida të rëndësishme në drejtim të zbatimit të plotë, koordinimit ndërsektorial dhe garantimit të aksesit të barabartë në shërbime cilësore për çdo fëmijë.

Gjatë periudhës 2021–2025 janë raportuar 170 nga 185 aktivitetet e planifikuara në Agjendë (92%), ku 64% e aktiviteteve rezultojnë plotësisht të realizuara, 27% pjesërisht të realizuara dhe 9% të parealizuara. Nga 20 tregues strategjikë të rezultateve, institucionet kanë raportuar për 17 prej tyre, ku 77% konsiderohen plotësisht të realizuar dhe 18% pjesërisht të realizuar.

Dokumenti synon të forcojë koherencën ndërmjet reformave sektoriale dhe prioriteteve kombëtare për fëmijët, të mbështesë zhvillimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të sigurojë një qasje të koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në adresimin e nevojave të tyre.

Miratimi i këtij dokumenti, synon të konsolidojë dhe forcojë sistemin kombëtar të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve përmes:

- Garantimit të vazhdimësisë dhe përfundimit të reformave të nisura në kuadër të Agjendës 2021–2026;
- Adresimit të boshllëqeve sistemike dhe rreziqeve të reja që prekin fëmijët;
- Forcimit të koordinimit ndërinstitucional, llogaridhënies dhe ofrimit të shërbimeve cilësore në nivel qendror dhe vendor;
- Harmonizimit të politikave kombëtare për të drejtat e fëmijëve me prioritetet, standardet dhe iniciativat e Bashkimit Evropian; dhe
- Forcimit të koherencës me strategjitë sektoriale dhe proceset kombëtare në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë, përfshirjes sociale dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Gjithashtu mundëson reflektimin në mënyrë të strukturuar dhe të matshme, të masave për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve të vitit 2023, si edhe forcimin më tej për përafrimin me standardet evropiane, në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të Ligjit Nr.18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Dokumenti strategjik parashikon politikat për fëmijët dhe është në harmoni me:

- Vërejtjet Përfundimtare të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës për Shqipërinë (2023);
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) të lidhura me fëmijët dhe mirëqenien e tyre;
- Politikat dhe iniciativat e Bashkimit Evropian, përfshirë Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Fëmijëve, Garancinë Evropiane për Fëmijët dhe iniciativa të tjera relevante të BE-së;
- Strategjia e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve;
- Garancia Evropiane për Fëmijët (European Child Guarantee);
- Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë 2025;
- Rekomandimi i Komisionit Evropian, datë 23.04.2024, për zhvillimin dhe forcimin e sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve në interesin më të lartë të fëmijës;
- Komenti i Përgjithshëm nr. 13 (2011) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës mbi të drejtën e fëmijës për të qenë i lirë nga të gjitha format e dhunës;
- Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave 2020–2025;
- Kuadri i ri strategjik i BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve rome;
- Komenti i Përgjithshëm nr. 12 (2009), "Mbi të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar";
- Rekomandimi CM/Rec(2012)2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve nën moshën 18 vjeç; dhe
- Rekomandimi i Këshillit të Evropës i datës 8 dhjetor 2022, "Mbi edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme": Objektivat e Barcelonës për vitin 2030.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Agjenda Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 2027–2030 strukturohet mbi tre qëllime strategjike kryesore:

1. Forcimin e qeverisjes qendrore, vendore dhe ndërsektoriale për garantimin e një sistemi të integruar, të financuar dhe të monitoruar në mënyrë efektive për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve;
2. Eliminimin e të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktikave të dëmshme ndaj fëmijëve, përmes parandalimit, mbrojtjes efektive, drejtësisë miqësore dhe shërbimeve të integruara; si dhe
3. Promovimin e mirëqenies, zhvillimit gjithëpërfshirës dhe mundësive të barabarta për çdo fëmijë, përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, mbrojtje sociale, transformim digjital dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Agjenda Kombëtare e Fëmijëve përfaqëson në të gjitha kuptimet e saj një strategji ndër-sektoriale. Përfituesit e veprimeve janë fëmijët dhe kjo përfshin çdo fushë të mundshme veprimi sektorial. Për më tepër, një nga synimet kryesore të strategjisë lidhet me koordinimin dhe forcimin e përgjegjshmërisë institucionale për të adresuar çështjet e fëmijëve.

Qëllimi strategjik I: Forcimi i qeverisjes qendrore dhe vendore dhe ndër-sektoriale për garantimin e një sistemi të integruar, të financuar dhe të monitoruar në mënyrë efektive për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve

Objektivi specifik I.1: Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në nivel qendror dhe vendor për koordinimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen efektive të politikave për fëmijët
Objektivi specifik II.1: Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe në mjedisin digjital përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërimit pozitiv.

Qëllimi strategjik II: Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktivave të dëmshme ndaj fëmijëve

Objektivi specifik II.2: Përmirësimi i kuadrit normativ si dhe forcimi i mekanizmave për raportimin, identifikimin dhe reagimin e shpejtë ndaj rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve (të fëmijëve në nevojë për mbrojtje).
Objektivi specifik II.3: Sigurimi i shërbimeve të integruara, të aksesueshme dhe cilësore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktima të dhunës, trafikimit, shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin online (të fëmijëve në nevojë për mbrojtje).
Objektivi specifik II.4: Forcimi i drejtësisë miqësore për fëmijët dhe mbrojtja efektive e fëmijëve viktima, dëshmitarë ose në konflikt me ligjin nga riviktimizimi dhe trauma sekondare.

Qëllimi strategjik III: Mirëqenie, zhvillim gjithëpërfshirës dhe mundësi të barabarta për çdo fëmijë përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike

Objektivi specifik III.1: Reduktimi i varfërisë së fëmijëve dhe forcimi i mbështetjes për familjet në situata vulnerabël
Objektivi specifik III.2: Sigurimi i aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës
Objektivi specifik III.3: Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në shërbime cilësore shëndetësore dhe mirëqenie psikologjike
Objektivi specifik III.4: Transformimi digjital dhe përdorimi etik i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në funksion të të drejtave të fëmijëve dhe mirëqënies së tyre

Zbatimi i AKDF 2027-2030 do të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe

Mbrojtjen e Fëmijës për procesin e mbledhjes së të dhënave, në kuadrin e monitorimit dhe raportimit të progresit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, Agjencia Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës Shtetërore (SASPAC), INSTAT-i, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Policia e Shtetit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË DO TË KONTRIBOJNË NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar dhe koordinuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me kontributin e grupit ndërinstitucional të punës, krijuar me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 547, datë 05.11.2025, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030", si dhe me mbështetjen e UNICEF, përmes një grupi ekspertësh, të cilët lehtësuan punën e GNP, në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri tek kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve. Kontribute kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë nga institucione të pavaruara, si edhe organizatat e shoqërisë civile, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

- Më 22 dhjetor 2025, u zhvillua takimi i parë i grupit ndërinstitucional të punës në të cilin u prezantua edhe raporti i monitorimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve për vitet 2021-2025.

- Në kuadër të procesit për hartimin e dokumentit strategjik, në datën 20 prill 2026 dhe në datën 26 maj 2026, janë zhvilluar dy takime me përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke dhënë sugjerime dhe komente lidhur me përmbajtjen e këtij draft dokumenti.

- Në datën 27 prill 2026 u realizua takimi i dytë, online, i grupit ndërinstitucional të punës ku u prezantua draft dokumenti paraprak, me qëllimet, parimet kryesore, objektivat dhe masat që përmban Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë muajit maj 2026, ka zhvilluar takime konsultative me përfaqësues të grupit ndërinstitucional të punës, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucioneve respektive lidhur me përcaktimin e indikatorëve, bazuar në objektivat dhe masat që përmban ky draft dokument.

- Fëmijët ishin pjesë e rëndësishme e procesit për hartimin e këtij dokumenti me pjesëmarrjen e tyre në takimet e zhvilluara në periudhën 21-26 maj 2026. Procesi u inicua nga MSHMS, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me mbështetjen e UNICEF dhe organizata të shoqërisë civile. Takimet kishin për qëllim për të dëgjuar dhe mbledhur pikëpamjet e fëmijëve lidhur me draft dokumentin.

Në total, u zhvilluan 5 takime me grupe të fokusuara, me pjesëmarrjen e 74 fëmijëve të grupmoshës nga 12-18 vjeç, nga 4 zona të Shqipërisë (Tiranë, Vorë, Kukës dhe Cërrik), në shkolla dhe qendra multifunksionale, ku ata përfitojnë shërbime të ndryshme, si edhe fëmijët që janë pjesë si vëzhgues, në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Mendimet dhe komentet e dhëna prej tyre, janë pasqyruar në masat e parashikuara në AKDF 2027-2030. Zëri i fëmijëve është gjithashtu një kapitull i veçantë në dokumentin strategjik.

- Draft dokumenti është konsultuar në datat 18.06.2026 - 16.07.2026, në faqen ëeb të MSHMS. Nga konsultimi publik rezultojne 848 shikime dhe nuk janë dhënë komente.

- Zyra e Kryenegociatorit në Kryeministri nëpërmjet emailit zyrtar të datës 16 nëntor 2026, ka përcjellë konfirmimin zyrtar "No – Objection" (mungesë kundërshtimi) të Komisionit Evropian, për vijimin e procedurave të miratimit të projektvendimit "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030".

Projektakti është dërguar për mendime në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator, INSTAT-i, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës Shtetërore (SASPAC), Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Ministria e Drejtësisë shprehet parimisht dakord, duke sugjeruar:

1.Riformulimin e aktivitetit *"II.2.2.b Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të vijës së parë për identifikimin e hershëm, raportimin, referimin dhe menaxhimin ndërsektorial të rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, në përputhje me procedurat standarde të mbrojtjes së fëmijëve dhe qasjen multidisiplinare të menaxhimit të rastit"*, si edhe rishikimin e rolit të institucioneve të përfshira për ndjekjen e këtij aktiviteti dhe heqjen e Ministrisë së Drejtësisë, si institucion bashkëpërgjegjës.

Lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se kjo masë nuk është riformuluar, për arsye se i referohet rritjes së kapaciteteve të profesionistëve që merren memenaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Ministria e Drejtësisë është hequr si institucion partner në këtë masë.

2.Lidhur me masën *"II.4.2.b Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve mbështetës (psikologë ndihmës, koordinatorë për viktimat, ekspertë dhe punonjës socialë dhe profesionistë të shërbimeve mbështetëse) për ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe mbështetjes së fëmijëve në kontakt me sistemin e drejtësisë"*, sugjeron heqjen e Ministrisë së Drejtësisë si institucion bashkëpërgjegjës për ndjekjen e këtij

Komenti është reflektuar, Ministria e Drejtësisë është hequr si institucion përgjegjës në këtë masë.

3.Lidhur me masën *"II.4.3.a Garantimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së privatësisë së fëmijëve gjatë proceseve hetimore dhe gjyqësore"*, sugjeron heqjen e Ministrisë së Drejtësisë si institucion bashkëpërgjegjës, duke qenë se konfidencialiteti dhe mbrojtja e privatësisë së fëmijëve në proceset hetimore dhe gjyqësore garantohet nga organi procedues dhe gjykata.

Komenti është reflektuar, Ministria e Drejtësisë është hequr si institucion në këtë masë. Gjithashtu sqarojmë se kjo masë është riformuluar me këtë përmbajtje: *"Zbatimi i procedurave të drejtësisë miqësore për fëmijët, duke siguruar mbrojtjen e privatësisë, konfidencialitetit dhe shmangien e riviktimizimit gjatë proceseve hetimore dhe gjyqësore"*.

4.Lidhur me aktivitetin: *"II.4.3.b Ofrimi i mbështetjes psikolologjike për fëmijët gjatë gjithë procesit të ndërveprimit me sistemin e drejtësisë*", sugjeron heqjen e Ministrisë së Drejtësisë si institucion përgjegjës dhe parashikimin e Urdhrit të Psikologut, duke qenë se prania e psikologut është e detyrueshme në çdo fazë të sistemit të drejtësisë".

Komenti është reflektuar, Ministria e Drejtësisë është hequr si institucion në këtë masë.

5. Projektvendimi i është përcjellë për mendim Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Përmbarimor Shtetëror, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në lidhje me aktivitetin *"II.4.1.c Zhvillimi i materialeve informuese miqësore për fëmijët*

mbi të drejtat dhe procedurat ligjore", sugjeron që të parashikohet si institucion përgjegjës për ndjekjen e këtij aktiviteti.

Komenti është reflektuar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është shtuar si institucion përgjegjës në këtë masë.

6. Të jepen shpjegime në relacionin shpjegues në lidhje me masën "II.2.1 dh Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi të brendshëm institucional në lidhje me njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe të shfrytëzimit të fëmijëve online", për të përcaktuar më saktë institucionin e ngarkuar me hartimin dhe kontribuesit në lidhje më këtë të fundit. Nisur nga titulli, përmbajtja e udhëzimit lidhet më tepër me fushën e përgjegjësisë së institucioneve ligjzbatuese se sa me atë të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithsesi mbetemi të hapur për të vijuar me kontributin tonë në lidhje me këtë masë.

Sqarojmë se për masën II.2.1 institucione përgjegjëse përveç Ministrisë së Drejtësisë janë edhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

7. Lidhur me masën *"II.2.1.a Rishikimi i Kodit të Familjes në kuadër të harmonizimit me ndryshimet ligjore të Ligjit 18/2017 për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe ligje të tjera që përmbajnë parashikime specifike për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve"*, vlerësohet se duhet të hiqet referenca *"dhe ligje të tjera që përmbajnë parashikime specifike për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve"*.

Komenti është reflektuar në tekstin e projektvendimit.

Ministria e Financave sugjeron:

- Në këndvështrimin buxhetor shprehen parimisht dakord, për sa kohë që hendeku i financimit paraqitet në nivel të qëndrueshëm, në masën 19% të kostos totale të strategjisë. Gjithashtu, nevojitet të mbahet në konsideratë që gjatë cikleve të ardhshme të PBA-së, të bëhet planifikimi adekuat i kostove, në përputhje me specifikimet sipas kësaj strategjie.
- Referuar financave vendore, zbatimi i masave të agjendës ku njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë edhe institucione përgjegjëse edhe kontribuese, mund të sjellë nevojë për rritje kapacitetesh institucionale tek NJVQV dhe shpenzime shtesë operative për shërbimet sociale dhe mekanizmat vendorë të mbrojtjes së fëmijëve.
- Lidhur me angazhimin e NJVQV në këtë agjendë, kërkojmë që në tabelën e kostimit të përcaktohet pjesa e kostos që pritet të mbulohet pushteti vendor, për të vlerësuar mundësinë e realizimit faktik të masave të propozuara.
- Në këtë kuadër duke qenë se projektakti ka impakt të drejtëpërdrejtë tek bashkitë, ky projekt-akt duhet të konsultohet dhe dakordësohet me NJVQV në përputhje me përcaktimet e ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

Sugjerimet e dhëna nga Ministria e Financave janë reflektuar në tekstin e projektvendimit dhe tabelën e kostimit. Projektakti është konsultuar në Këshillin Konsultativ të Vetëqeverisjes Vendore.

Ministria e Arsimit sugjeron:

1. Në faqen 3 të listës së shkurtimeve dhe kudo në përmbajtje të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, togfjalëshi *"DAR / ZA - Drejtoria Arsimore Rajonale /Zyra Arsimore"*, të zëvendësohet me togfjalëshin *"DRAP/ZVAP, -Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar/Zyra Vendore e Arsimit Parauniveristar"*. I njëjti sugjerim të mbahet në konsideratë edhe për zëvendësimin e termit *"ZVA"*, me termin *"ZVAP"*, kudo në përmbajtje të praktikës.

Komenti është reflektuar në të gjithë tekstin e projektvendimit.

2. Në faqen 29 dhe kudo në përmbajtje të projektvendimit dhe praktikës shoqëruese të tij, togfjalëshi *"Strategjisë së Arsimit Parauniversitar"*, të zëvendësohet me togfjalëshin *"Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"*, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave.

Komenti është reflektuar në tekstin e projektvendimit.

3. Në faqen 44, në Masën III.2.1 dhe në faqen 58, në Masën III.2.1 të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, *"Mbi garantimin e aksesit të barabartë në arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë fëmijët, si dhe mbi përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së arsimit për të gjithë fëmijët"*, të qartësohet roli i Ministrisë së Arsimit (MA) nëse do të jetë si institucion përgjegjës apo si institucion kontribues, në kushtet që parashikohet në të dyja këto role për zbatimin e këtyre masave.

Komenti është reflektuar në tekstin e projekvendimit, duke vendosur MA si institucion përgjegjës lidhur me këtë masë.

5. Në faqen 45, në Masën III.4.2 mbi përmirësimin e infrastrukturës digjitale në arsim për akses të barabartë të fëmijëve në teknologji, MA të hiqet sepse është përmendur dy herë. Komenti është reflektuar në tekstin e projektvendimit.

6.Në faqen 48, tek Masa I.1.1.i mbi zhvillimin dhe integrimin e moduleve mbi etikën profesionale dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në programet e studimit të gazetarisë dhe komunikimit, me fokus në raportimin etik, konfidencialitetin dhe trajtimin e rasteve që përfshijnë të mitur, togfjalëshi *"Fakulteti i Gazetarisë"*, të zëvendësohet me togfjalëshin *" Fakulteti Historisë dhe Filologjisë UT"*.

Komenti është reflektuar në të gjithë tekstin e projektvendimit.

Ministria e Punëve të Brendshme shprehet parimisht dakort me përmbajtjen e projektaktit, duke sugjeruar:

1. Në objektivin specifik II.2 *"Përmirësimi i kuadrit normativ, si dhe forcimi i mekanizmave për raportimin, identifikimin dhe reagimin e shpejtë ndaj rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje"*, në paragrafin e fundit, sugjerojmë që togfjalëshi "KRAT", të zëvendësohet me togfjalëshin "ekipe multidisiplinare (si GTN, Tryezat Teknike etj.)".

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit duke hequr togfjalëshin "KRAT", si edhe është ndryshuar përmbajtja e paragrafit.

2. Në tabelën 1 "Kosto indikative e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, sipas qëllimeve, objektivave dhe masave", te masa II.4.2 *"Rritja e kapaciteteve të profesionistëve për trajtimin e fëmijëve në sistemin e drejtësisë"*, sugjerohet që Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) të hiqet nga lista e institucioneve përgjegjëse. Komenti është reflektuar.

3. Në tabelën 1 "Kosto indikative e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, sipas qëllimeve, objektivave dhe masave", te masa II.4.3 "Parandalimi i riviktimizimit dhe traumës sekondare gjatë procedurave ligjore", sugjerohet që Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) të hiqet nga lista e institucioneve përgjegjëse.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit duke hequr Ministria e Punëve të Brendshme si institucion përgjegjës, në tabelë.

4. Në aneksin 1, në objektivin specifik II.2, masa II.2.3.ë "Ngritja e kapaciteteve të ekipeve ndërsektoriale (KRAT), në bazë të moduleve të certifikuara dhe të miratuara nga ASCK, mbi parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktima/viktima të mundshme të trafikimit", sugjerohet që të hiqet togfjalëshi "KRAT", pasi ky mekanizëm përfshin edhe të rriturit.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

5. Në aneksin 1, në objektivin specifik II.3, masa II.3.1.dh "Ngritja e kapaciteteve për hetuesit dhe oficerët e policisë të përfshirë specifikisht në hetimin e rasteve të abuzimit seksual ndaj fëmijëve dhe shfrytëzimit online", sugjerohet që Ministria e Punëve të Brendshme, si institucion përgjegjës, të zëvendësohet me Policinë e Shtetit dhe Akademinë e Sigurisë.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit duke e hequr MPB nga kjo masë duke vendosur Policinë e Shtetit dhe Akademinë e Sigurisë.

6. Në aneksin 1, në objektivin specifik II.3, masa II.3.1.e "Përmirësimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës së Laboratorit Shkencor të Policisë për mbledhjen dhe analizimin efektiv të të dhënave digjitale që lidhen me krimet online ndaj fëmijëve", sugjerohet që Ministria e Punëve të Brendshme të hiqet nga lista e institucioneve përgjegjëse.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

7. Në aneksin 1, në objektivin specifik II.3, masa II.3.1.g "Sigurimi i aksesit të barabartë dhe të vazhdueshëm në shërbime arsimore, shëndetësore, psikosociale dhe ligjore për fëmijët e paregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare", sugjerohet që, krahas Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të shtohen si institucione përgjegjëse edhe Ministria e Arsimit (MA) dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), si institucione përgjegjëse për garantimin e aksesit në shërbimet arsimore dhe shëndetësore.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit duke shtuar MA dhe MSHMS.

8. Në aneksin 1, në objektivin specifik II.4, masa II.4.2.a "Trajnimi i punonjësve të policisë dhe policisë gjyqësore në lidhje me të drejtat e viktimave të krimit, përdorimin e teknologjisë audio-video, teknikat e komunikimit dhe intervistimit, aspektet psikologjike, vlerësimin individual etj.", sugjerohet që Ministria e Punëve të Brendshme të hiqet nga lista e institucioneve përgjegjëse.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

9. Në aneksin 1, në objektivin specifik II.4, masa II.4.3.a "Garantimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së privatësisë së fëmijëve gjatë proceseve hetimore dhe gjyqësore", sugjerohet që Ministria e Punëve të Brendshme të hiqet nga lista e institucioneve përgjegjëse, pasi nuk është institucioni përgjegjës për kryerjen e hetimeve.

Lidhur me këtë koment, theksojmë se është ndryshuar formulimi i masës dhe është bërë "Zbatimi i procedurave të drejtësisë miqësore për fëmijët, duke siguruar mbrojtjen e privatësisë, konfidencialitetit dhe shmangien e riviktimizimit gjatë proceseve hetimore dhe gjyqësore".
Po kështu edhe MPB është hequr si institucion në këtë masë.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit sugjeron:
1. Të përditësohet emërtimi i institucionit në projektvendim, në përputhje me ndryshimet e përcaktuara në VKM nr. 516, datë 25.09.2025, lidhur me fushat e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

2. Të plotësohen objektivat dhe masat e projektvendimit me parashikime që forcojnë mbrojtjen

e fëmijëve në mjedisin digjital, përmes mekanizmave për raportimin dhe trajtimin e incidenteve online, zbatimit të parimeve Safety by Design, Privacy by Design dhe Age Appropriate Design, konfigurimeve të sigurta të privatësisë, protokolleve të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe masave teknike për garantimin e një mjedisi të sigurt online në institucionet arsimore.

Sugjerimi është reflektuar në Objektivin II.1-Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe në mjedisin digjital përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërimit pozitiv.

3. Në Kreun I.3 "Vizioni i Strategjisë dhe Qëllimet Strategjike", nënseksioni "Përfshirja aktorëve dhe grupeve të interesit", referenca për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit të riformulohet duke përfshirë edhe fushën e strehimit, krahas inovacionit, transformimit digjital dhe aftësive të së ardhmes.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

4. Në përputhje me kompetencat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit në fushën e strehimit social, si dhe me nenet 60 dhe 61 të ligjit nr. 22/2018, "Për Strehimin Social", të ndryshuar, të përfshihet Ministria si institucion kontribues në masat që lidhen me strehimin social, banesat e specializuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe programet e tranzicionit drejt pavarësisë për të rinjtë që dalin nga sistemi i kujdesit alternativ.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit në masën III.1.1.c.

5. Gjithashtu, në të gjitha masat dhe aktivitetet që lidhen me akomodimin emergjent, strehimin social, mbështetjen e familjeve në nevojë dhe programet e strehimit për grupet në nevojë, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit propozohet të përfshihet si institucion përgjegjës ose bashkëpërgjegjës, sipas rastit.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit, duke e përfshirë MEI në masat respektive, II.2.3.gj, I.1.1.k, II.3.1.a

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është shprehur parimisht dakord, duke sugjeruar që për masën I.1.1.e "Zhvillimi i një mekanizmi monitorues (dashboard) për ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve "CRC, CEDAË, UPR", të sqarohet nëse ky institucion do të ketë detyrime financiare, pasi në buxhetin për vitet 2027-2029, nuk është planifikuar apo dedikuar buxhet për zbatimin e kësaj mase.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se MEPJ është hequr si institucion përgjegjës dhe është vendosur si institucion kontribues. Për këtë masë janë përfshirë vetëm kostot administrative, si çdo institucion.

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, Agjencia Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës Shtetërore (SASPAC), INSTAT, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, janë shprehur parimisht dakord.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, shprehet dakort me përmbajtjen e projektaktit, por sugjeron për masën II.4.3.a *"Garantimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së privatësisë së fëmijëve gjatë proceseve hetimore dhe gjyqësore"*, riformulimin e kësaj pike, pasi nuk mund të zhvillohen procedura të veçanta vetëm për konfidencialitetin, pasi një ndër parimet e punës së strukturave të policisë është ruajtja e konfidencialitetit.

Është reflektuar duke u riformuluar masa më këtë përmbajtje: *"Zbatimi i procedurave të drejtësisë miqësore për fëmijët, duke siguruar mbrojtjen e privatësisë, konfidencialitetit dhe shmangien e riviktimizimit gjatë proceseve hetimore dhe gjyqësore"*.

Avokati i Popullit

1. *Të parashikohet shprehimisht një rol i pavarur monitorues për Agjendën për Avokatin e Popullit, përmes Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, me paraqitjen e një vlerësimi vjetor të pavarur para KKDMF-së dhe Grupit Parlamentar "Miqtë e Fëmijëve", paralelisht me raportin e ASHDMF-së.*

Ky koment është reflektuar në masën I.1.1.ë të projektvendimit.

2. *Të parashikohen "shkas-pasojë" të llogaridhënies: në rast mosarritjeje të treguesve ose mosraportimi, të aktivizohet detyrimi për shqyrtim e masa korrigjuese në KKDMF, debat i detyrueshëm parlamentar dhe raportim publik me sistem të tillë si, i realizuar / pjesërisht / i parealizuar, për çdo masë.*

Lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se legjislacioni në fuqi për të drejtat e fëmijëve përcakton detyrimet e institucioneve për raportim dhe bashkërendim të gjithë aktorëve të mekanizmit kombëtar për të drejtat e fëmijëve.
Gjithashtu ky koment është reflektuar në masën I.1.1.b të projektvendimit.

3.Të eliminohet progresivisht hendeku financiar i Agjendës, duke përcaktuar burime të qëndrueshme financimi në Buxhetin e Shtetit dhe duke miratuar një mekanizëm të rregullt monitorimi e raportimi mbi ecurinë e mbulimit të tij, me objektiva vjetore të matshme. Në këtë proces, përparësi t'u jepet masave që ndikojnë drejtpërdrejt në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, me qëllim që zbatimi i tyre të mos cenohet nga mungesa e fondeve apo varësia nga financimi i jashtëm.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se identifikimi dhe pasqyrimi i tij në analizën buxhetore është bërë pikërisht për të evidentuar nevojat e pambuluara financiare dhe për të mbështetur planifikimin e tyre në ciklet e ardhshme të Programit Buxhetor Afatmesëm

(PBA), si edhe mobilizimin e burimeve shtesë të financimit, sic është edhe pasqyruar në kapitullin përkatës të analizës buxhetore.

4. Të sigurohet përfundimi në afat i analizës së kostimit të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe, në vijim, të miratohen aktet nënligjore përkatëse që operacionalizojnë kostimin dhe blerjen e këtyre shërbimeve nga bashkitë, duke krijuar bazën për një financim të parashikueshëm dhe ofrim të barabartë të shërbimeve në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky koment është i parashikuar në masën II.2.1.dh të projektvendimit.

5.Të përfshihet shprehimisht aksesi i drejtpërdrejtë i fëmijëve te Avokati i Popullit përmes proçedurave miqësore për fëmijët, garantimi i mjeteve të dëmshpërblimit për shkeljet, aksesi efektiv në procedurën OPIC, si dhe një tregues mbi numrin e ankesave të pranuara e të zgjidhura.

Ky propozim është reflektuar në masën I.1.1.dh të projektvendimit.

6.Të shtohet vëmendje e shprehur për fëmijët e lënë pas nga emigracioni, fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët e prindërve të dënuar, dhe të garantohet mbulimi i të gjitha kategorive për mosdiskriminim.

Reflektuar në masat e Objektivit specifik II.3 "*Sigurimi i shërbimeve të integruara dhe cilësore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktima të të gjitha formave të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit*", të projektvendimit.

7.Të riorientohen masat për aftësinë e kufizuar drejt përfshirjes, me garanci kundër izolimit, dhe të forcohet regjistrimi civil universal i fëmijëve.

Reflektuar në masat e Objektivit specifik II.3 "*Sigurimi i shërbimeve të integruara dhe cilësore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktima të të gjitha formave të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit*", të projektvendimit.

8.Të merret përsipër plotësimi i të gjitha baseline-ve brenda një afati të përcaktuar (p.sh. fundi i vitit 2027), të bëhet i detyrueshëm ndarja e të dhënave sipas (gjini, moshë, aftësi e kufizuar, etni, territor, status migrator/regjistrimi) për të gjithë treguesit, në harmoni me INSTAT dhe anketën MICS 2030; institucionet e pavarura duhet të kenë akses në të dhëna për qëllime *monitorimi.*

Është marrë në konsideratë duke u pasqyruar në përmbajtjen e projektvendimit.

9.Të shtohen masa për të drejtat e fëmijëve dhe biznesin: detyrime e udhëzime për sektorin privat dhe platformat digjitale; mbrojtje nga reklamimi i dëmshëm dhe profilizimi; dhe harmonizimi i masave për inteligjencën artificiale në arsim me parimin e "të drejtave të fëmijëve që në dizajn" dhe garancitë e mbrojtjes së të dhënave.

Është reflektuar në masën I.1.1.k të projektvendimit.

10. Të forcohet dimensioni klimë/emergjenca, me tregues specifikë për fëmijët dhe garanci për vijueshmërinë e shërbimeve të mbrojtjes e të arsimit gjatë krizave.

Është reflektuar në masën I.1.1.gj të projektvendimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sugjeron që lidhur me masën I.1.1.dh "*Vijimi dhe konsolodimi i mëtejshëm i raportimit vjetor të institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut mbi trajtimin e ankesave dhe monitorimin e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, përfshirë integrimin e të dhënave për të drejtat e fëmijëve në raportet e tyre vjetore dhe raportimin në KKDMF dhe Grupin Parlamentar "Miqtë e Fëmijëve*", të mos jetë institucion përgjegjës, por monitorues.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike sugjeron:

1. Përcaktimin e rolit që ka AKSK-së për sigurinë online, mbrojtjen nga rreziqet kibernetike dhe promovimin e një mjedisi digjital të sigurtë për fëmijët.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektaktit në kapitullin "Përfshirja e aktorëve dhe grupeve të interesit".

2. Lidhur me masën II.1.4. "*Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve përmes edukimit mbi sigurinë digjitale, përdorimin e sigurt të internetit, parandalimin dhe raportimin e dhunës online, si dhe mbrojtjen e privatësisë dhe integritetit të tyre në mjedisin digital*", thekson se kjo masë është e përsëritur dhe duke qenë se buxheti nuk është miratuar ende në këtë fazë nuk është e mundur të përcaktohen kostot përfundimtare të kësaj mase.

Sqarojmë se:

2.a Lidhur me aspektin financiar të kësaj mase do të realizohen me burimet njerëzore ekzistuese në strategji. Kostoja përkatëse është llogaritur në zërat buxhetorë për pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore. Aktivitetet e lëna si boshllëk financimi ose për tu mbuluar nga donatorët, përbëjnë një mundësi për institucionet përgjegjëse që të bashkëpunojnë me donatorët për sigurimin e financimit të masave të parashikuara.

2.b Nuk rezulton se masa II.1.4 është e përsëritur me një masë tjetër të Agjendës. Masa II.1.4 përbën objektivin e përgjithshëm në kuadër të Qëllimit Strategjik II për parandalimin e dhunës dhe rreziqeve në mjedisin digjital, ndërsa nënmasat II.1.4.a–II.1.4.e adresojnë komponentë të ndryshëm dhe plotësues të këtij objektivi (aksesin në teknologji, edukimin, ndërgjegjësimin, trajnimin e prindërve, bashkëpunimin ndërinstitucional, protokollet dhe mekanizmat e raportimit). Për rrjedhojë, nuk konstatohet mbivendosje, por një ndarje funksionale e ndërhyrjeve.

3. Lidhur me masën III.1.1 "Zhvillimi i sistemit të kujdesit alternativ dhe përshpejtimi i procesit të deinstitucionalizimit", thekson se kjo masë nuk bën pjesë në fushën e saj të kompetencave.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit, duke e hequr AKSK si institucion.

4. Lidhur me masën III.4.1 *"Përmirësimi i infrastrukturës digjitale në arsim për të garantuar akses të barabartë të fëmijëve në teknologji dhe mjedise të sigurta digjitale, me koordinimin teknik të AKSHI për zhvillimin, integrimin dhe standardizimin e zgjidhjeve teknologjike"*, AKSK thekson se kjo masë nuk bën pjesë në fushën e saj të kompetencave.

Lidhur me këtë masë vlerësojmë se AKSK është vendosur si institucion kontribues, pasi AKSK duhet të japë kontributin e tij si institucion në zbatimin e komponentëve të kësaj mase, që lidhen me promovimin e sigurisë në internet, edukimin dhe ndërgjegjësimin për përdorimin e sigurt, etik dhe të përgjegjshëm të teknologjive digjitale, përfshirë inteligjencën artificiale, në përputhje me mandatin e tij institucional.

5. Lidhur me masën II.1.4.c *"Zhvillimi dhe zbatimi i ndërhyrjeve të integruara për sigurinë e fëmijëve në internet, për fëmijët, prindërit dhe komunitetin shkollor, përmes materialeve informuese, programeve edukative dhe fushatave ndërgjegjësuese mbi përdorimin e sigurt të internetit dhe parandalimin e rreziqeve digjitale"*, shprehet se duke qenë se buxheti nuk është miratuar ende në këtë fazë nuk është e mundur të përcaktohen kostot përfundimtare të kësaj mase.

Për aspektin financiar të kësaj mase theksojmë se do të realizohen me burimet njerëzore ekzistuese në strategji kostoja përkatëse është llogaritur ne zërat buxhetorë për pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore.

6. Lidhur me masën II.1.4 ç *"Zhvillimi i programeve të trajnimit për prindërit mbi mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe përdorimin e sigurt të teknologjisë për fëmijët dhe procedurat bazë për kërkimin e ndihmës dhe raportimin e rasteve"*, shprehet se duke qenë se buxheti nuk është miratuar ende në këtë fazë nuk është e mundur të përcaktohen kostot.

Lidhur me aspektin financiar të kësaj mase theksojmë se do të realizohen me burimet njerëzore ekzistuese në strategji kostoja përkatëse është llogaritur ne zërat buxhetorë për pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore.

7. Për masën II.1.4.dh *"Përditësimi i protokolleve/procedurave për sigurinë në shkolla", duke përfshirë:*

- *sigurinë kibernetike dhe sjelljen etike në mjediset digjitale;*
- *procedurat për identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës digjitale ndaj fëmijëve*
- *lidhjen me mekanizmat ekzistues të mbrojtjes së fëmijëve (NjMF, Policia e Shtetit,*

strukturat përkatëse)", thekson se kjo masë nuk bën pjesë në fushën e saj të kompetencave.

Lidhur me komentin vlerësojmë se edhe pse përgjegjësia për hartimin dhe miratimin e protokolleve/procedurave për sigurinë në shkolla nuk është në kompetencë të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, AKSK mund të kontribuojë në hartimin e përmbajtjes së komponentëve që lidhen me sigurinë kibernetike, përdorimin e sigurt dhe etik të teknologjive digjitale, si dhe procedurat bazë për identifikimin dhe raportimin e incidenteve në mjedisin digjital, në përputhje me mandatin dhe ekspertizën e tij. AKSK është vendosur si institucion kontribues në këtë masë.

8. Lidhur me masën II.1.4.e *"Krijimi dhe funksionalizimi i një rrjeti kombëtar të mbështetjes digjitale për sigurinë online dhe mirëqenien e nxënësve, që përfshin:*

- *platforma dhe linja këshillimi për fëmijët dhe prindërit*
- *mekanizma të thjeshtuar dhe të aksesueshëm për raportimin e rasteve*
- *orientimin e rasteve drejt strukturave të mbrojtjes dhe zbatimit të ligjit (NjMF,Policia, Prokuroria sipas rastit)"*, thekson se në këtë masë ka kompetence vetëm lidhur me pjesën e mekanizmave të thjeshtuar dhe të aksesueshëm për raportimin e rasteve.

Komenti reflektohet dhe do të merret në konsideratë raportimi lidhur me çështjet e mekanizmave të thjeshtuar dhe të aksesueshëm për raportimin e rasteve.

9. Lidhur me masën III.1.1.dh *"Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve të shërbimeve sociale për zbatimin e standardeve të kujdesit alternativ dhe mbrojtjes së fëmijëve"*, thekson se kjo masë nuk bën pjesë në fushën e saj të kompetencave.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

10. Lidhur me masën III.4.1.a *"Promovimi i sigurisë së fëmijëve në internet dhe përdorimit etik e të përgjegjshëm të teknologjive digjitale, përfshirë inteligjencën artificiale, përmes programeve ndërgjegjësuese dhe edukative për prindërit, mësuesit dhe fëmijët, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave, privatësisë dhe mirëqenies së tyre në mjedisin digjital"*, shprehet se duke qenë se buxheti nuk është miratuar ende në këtë fazë nuk është e mundur të përcaktohen kostot

Lidhur me aspektin financiar të kësaj mase theksojmë se do të realizohen me burimet njerëzore ekzistuese në strategji kostoja përkatëse është llogaritur ne zërat buxhetorë për pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare sugjeron:

1. Lidhur me masën II.2.1.d *"Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi ndërinstitucional për njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve online"*, shprehet se nuk ka kompetencë ligjore për rregullimin

dhe monitorimin e përmbajtjeve të shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, nuk mund të lëshojë urdhra që kanë si objekt heqjen e përmbajtjeve online dhe në këto kushte nuk mund të jetë institucion kontribues në hartimin e udhëzimit të parashikuar në këtë pikë.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

2. Lidhur me masën III.4.1.a "*Promovimi i sigurisë së fëmijëve në internet dhe përdorimit etik e të përgjegjshëm të teknologjive digjitale, përfshirë inteligjencën artificiale, përmes programeve ndërgjegjësuese dhe edukative për prindërit, mësuesit dhe fëmijët, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave, privatësisë dhe mirëqenies së tyre në mjedisin digjital*", shprehet se mund të fokusohet vetëm në rolin e ndërmjetësuesit, me ofruesit e shërbimeve elektronike, sa i përket marrjes së masave shtesë të sigurisë së rrjetit në projektet arsimore.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit, duke e vendosur AKEP si institucion kontribues në këtë masë.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, sugjeron:

1. Në përmbajtjen e draft- Agjendës sugjerojmë që të parashikohet përdorimi, për aq sa është e mundur, i sistemeve ekzistuese kombëtare të informacionit dhe i të dhënave që administrohen, duke shmangur krijimin e databazave apo mekanizmave paralelë të raportimit.

Ky koment është marrë në konsideratë duke u reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit dhe specifikisht në masat II.1.3.gj dhe III.2.1.h.

2. Lidhur me shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve, sugjerojmë të përcaktohet se ndërveprimi duhet të realizohet përmes infrastrukturës dhe mekanizmave shtetërore të ndërveprimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për qeverisjen elektronike, mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë kibernetike.

Ky koment është marrë në konsideratë duke u reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

3. Lidhur me përmirësimin e infrastrukturës digjitale, monitorimin e treguesve, përdorimin e teknologjive inovative dhe inteligjencës artificiale në arsim, sugjerojmë që, para përcaktimit të zhvillimeve të reja teknologjike, të realizohet hartëzimi i treguesve dhe kërkesave të Agjendës me të dhënat dhe funksionalitetet ekzistuese të sistemeve kombëtare të arsimit, me qëllim identifikimin e nevojave konkrete për zhvillime, integrime apo raporte të reja. Pasi pjesa më e mirë e treguesve tashmë mund të jenë të realizuara në sistemet aktuale që kemi ngritur për Ministrinë e Arsimit.

Lidhur me këtë sugjerim është shtuar në përmbajtjen e projektvendimit një masë e re *"III.2.1.h Hartëzimi i treguesve të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve me*

sistemet kombëtare ekzistuese të informacionit në arsim, me qëllim identifikimin e nevojave për zhvillime, integrime dhe përmirësime të monitorimit të treguesve".

4. Për sistemet dhe platformat digjitale që përpunojnë të dhëna të fëmijëve, veçanërisht në kuadër të zhvillimeve të reja dhe përdorimit të teknologjive të inteligjencës artificiale, sugjerojmëqë, të parashikohet zbatimi i kërkesave të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave që në fazën e konceptimit dhe projektimit të zgjidhjeve teknologjike, si dhe mekanizma të përshtatshëm për kontrollin e aksesit, gjurmueshmërinë e veprimeve dhe vlerësimin periodik të sigurisë.

Lidhur me këtë sugjerim tek masa: III.4.2.a *"Zgjerimi i platformave të mbështetura nga Inteligjenca Artificiale për mësim të personalizuar"*, është shtuar paragrafi *"duke garantuar zbatimin e standardeve të sigurisë kibernetike, mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijëve, përfshirë mekanizmat e kontrollit të aksesit, gjurmueshmërisë së veprimeve dhe vlerësimit periodik të sigurisë".*

5. Lidhur me përmbajtjen e Masës III.4.1 të draft Agjendës, sugjerojmë që të përcaktohet se AKSHI do të ketë rolin e koordinatorit teknik.

Ky koment është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

6. Lidhur me përmbajtjen e Masës III.4.2 të draft Agjendës, sjellim në vëmendjen tuaj se AKSHI është institucioni kryesor për zhvillimin e platformave digjitale dhe integrimin e teknologjive të reja. Duke qenë se ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Inteligjencën Artificiale, e cila përfshin udhëzuesin për përdorimin e AI në arsim, sugjerojmë që ky udhëzues të përdoret si bazë për zbatimin e masave të Agjendës, në përputhje me praktikat e BE-së.

Ky koment është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit duke riformuluar masën III.4.2.b *"Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve për përdorimin e inteligjencës artificiale gjeneruese në arsim, në përputhje me Udhëzuesin për përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Arsim, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Inteligjencën Artificiale".*

7. Lidhur me përmbajtjen e Masës III.4.1.b të draft Agjendës, sugjerojmë që AKSHI të vendoset si institucion përgjegjës.

Ky koment është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

8. Lidhur me përmbajtjen e Masës III.4.3.c të draft Agjendës, sjellim në vëmendjen tuaj se, AKSHI mund të japë mbështetje teknike dhe të zhvillojë projekte pilot për edukimin digjital, duke ofruar platforma interaktive dhe materiale mbi AI, mbështetur në projektet e Smart Labs.

Sqarojmë se kjo masë është hequr dhe nuk është më në përmbajtjen e projektvendimit.

9. Lidhur me përmbajtjen e Masës III.2.1.h të draft Agjendës, sugjerojmë që të riformulohet duke mbajtur në konsideratë mundësinë e përdorimit të një nga sistemet ekzistues.

Ky koment është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, është shprehur parimisht dakort me përmbajtjen e projektvendimit, por sugjeron:

1. Lidhur me masën II.2.1 *"Forcimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe acquis të Bashkimit Evropian"*, të mos jetë institucion përgjegjës në këtë masë, por institucion kontribues.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

2. Lidhur me masën I.1.1.f, tani në projktvendim masa I.1.1.g *"Ngritja dhe funksionimi i një grupi pune ndër-sektoriale për të hartuar dhe koordinuar iniciativën e qyteteve miqësore për fëmijët/adoleshentët, në koordinim me KKDMF"*, të mos jetë institucion përgjegjës në këtë masë, por institucion kontribues.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

3. Lidhur me masën II.2.2.gj bërë tani masa II.2.2.f *"Hartimi dhe zbatimi, në bashkëpunim ndërinstitucional, i planeve vendore për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sjelljeve me rrezik tek fëmijët dhe të rinjtë, me fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin për ushqyerjen e shëndetshme, aktivitetin fizik, parandalimin e obezitetit, duhanpirjes, përdorimit të alkoolit dhe substancave narkotike, në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare sektoriale përkatëse"*, të mos jetë institucion përgjegjës në këtë masë, por institucion kontribues.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit.

Këshilli Konsultativ me anë të Vendimit nr. 8, datë 22.07.2026, sugjeron për masën II.4.3.a riformulimin e kësaj pike, pasi nuk mund të zhvillohen procedura të veçanta vetëm për konfidencialitetin, pasi një ndër parimet e punës së strukturave të policisë është ruajtja e konfidencialitetit.

Komenti është reflektuar në përmbajtjen e projektvendimit duke ndryshuar formulimin e kësaj mase në *"Zbatimi i procedurave të drejtësisë miqësore për fëmijët, duke siguruar mbrojtjen e privatësisë, konfidencialitetit dhe shmangien e riviktimizimit gjatë proceseve hetimore dhe gjyqësore"*.

Projektakti do të dërgohet për bashkërendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë

Kibernetike, Autoritetin të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projekakti janë përllogaritur për çdo aktivitet të AKDF 2027-2030, duke mbajtur në konsideratë produktet dhe treguesit e përcaktuar.
Kostimi i Planit është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikës së planifikimit buxhetor, me qëllim përcaktimin e kostove indikative mbështetur në qëllimet, masat, treguesit e përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në produktet e identifikuara për secilin aktivitet.
Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin me Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 (faza e II), të të gjitha ministrive që kanë masa në këtë plan dhe institucionet e varësisë që janë përfshirë në zbatimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, si dhe në kostot e strategjive të tjera të listuara në këtë dokument dhe kanë ndihmuar për hartimin e aktiviteve.

Plani i Veprimit për zbatimin e dokumentit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Gjatë procesit të kostimit janë identifikuar shpenzimet për secilin aktivitet të detajuar dhe ato janë klasifikuar sipas kategorive të paracaktuara të shpenzimeve.

Metodologjia e përdorur për kostimin dhe ndarjen e tyre bazohet në një strukturë të qartë klasifikimi, e cila parashikon ndarjen e shpenzimeve në kategoritë e mëposhtme:

- Paga dhe sigurime shoqërore;
- Shpenzime operative;
- Trajnime, studime, asistenca teknike, etj.;
- Investime.

Ky klasifikim mundëson një paraqitje të qartë dhe të strukturuar të kostove, duke lehtësuar analizën, planifikimin dhe monitorimin e tyre. Përllogaritjet janë realizuar sipas viteve financiare, duke paraqitur një shpërndarje të qartë të fondeve/për aktivitet/për objektiv/për qëllim, për secilën fushë përkatëse.

Kostoja totale për zbatimin e agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2027-2030, është vlerësuar në një vlerë prej 1 809 030 795 (Një miliard e tetëqind e nëntë milionë e tridhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë.) lekë.

E cila shpërndahet si më poshtë:

1,268,509,886 (Një miliard e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, të vlerësuar kontribut nga Buxheti i Shtetit;

347,406,000 (Treqind e dyzet e shtatë milionë e katërqind e gjashtë mijë) lekë, të parashikuar për t'u siguruara nga donator/financim i huaj;

193,114,909 (Njëqind e nëntëdhjetë e tre milionë e njëqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntë. lekë, hendek financiar, i cili mund të mbulohet përmes:

- rishikimit dhe prioritizimit të masave brenda tavaneve të Programit Buxhetor Afatmesëm gjatë cikleve të ardhshme buxhetore;
- mobilizimit të fondeve nga instrumentet e asistencës së huaj, nëpërmjet organizateve të UN,ËHO, etj, përfshirë edhe programet e Bashkimit Evropian (si p.sh. IPA) dhe projekte të tjera të financuara nga partnerët zhvillimorë ndërombëtarë. Programimi i këtyre fondeve realizohet në përputhje me ciklet shumëvjeçare të planifikimit dhe kuadrot përkatëse të bashkëpunimit (marrëveshje/memorandume mirëkuptimi), mbi bazën e prioriteteve të dakordësuara me palën shqiptare. Në këtë kontekst, angazhimet buxhetore reflektohen në mënyrë të fazuar në periudhat pasuese, duke integruar gradualisht edhe nevojat e pambuluara të identifikuara në kuadër të Agjendës;
- zgjerimit të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare dhe donatorë bilateralë për financimin e ndërhyrjeve specifike; si dhe shfrytëzimit të skemave të bashkëfinancimit dhe mekanizmave të tjerë financiarë, aty ku është e aplikueshme.

PROPOZUESI

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Klodiana SPAHIU